



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.985/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Bashkim Podrimqakut, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.985/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Bashkim Podrimqaku, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet VV 1723C/02R, VV 1723C/02R, VV 1723C/05R, VV 1723C/03R, VV 1706C/04R, VV 1725C/02R, në komunën e Pejës.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.985/2021 të paraqitur nga Bashkim Podrimqaku, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se në vendvotimet VV 1723C/02R, VV 1723C/02R, VV 1723C/05R, VV 1723C/03R, VV 1706C/04R, VV 1725C/02R, ka pasur manipulime të votave. Si dëshmi krahas apelit ka bashkangjitur deklaratat e votuesve të cilët pretendon se kanë votuar me postë me rekomandë si dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatit.

PZAP, me datë 07.11.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje KQZ-së lidhur me listën e votuesve jashtë vendit me të cilën i ka kërkuar që të verifikojë listën në fjalë me qëllim që të vërtetojë pretendimet si në apel.

KQZ, përmes emailit zyrtar i ka dërguar PZAP-së, përgjigje në kërkesë ashtu që nga e njëjta rezultojnë se deklaruesit e paraqitur si në apel se kanë votuar me postë rekomandë për kandidatin nga Bashkim Podrimqaku, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Komunën e Pejës, nuk kanë aplikuar

në periudhën e Aplikimit të Regjistrimit për Votim jashtë Kosovës, ashtu që këta persona në bazën e të dhënave që janë krijuar si rezultat i aprovimit të pakove me fletëvotime e në raste të tilla pakoja me fletëvotime nuk procedohet për numërim në QNR.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Bashkim Podrimqakut, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Pejës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën kërkon rinumërim të votave në Vendvotimet VV 1723C/02R, VV 1723C/02R, VV 1723C/05R, VV 1723C/03R, VV 1706C/04R, VV 1725C/02R, në Komunën e Pejës është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi e apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, nga shtatë deklaratat e ofruara si provë krahas apelit e që rezultojnë të jenë të adresuara me postë rekomande, pas verifikimit nga të dhënat zyrtare për votat me postë rezulton se për kandidatin në fjalë rezultojnë të jenë gjithsej zero vota si dhe nga përgjigja e KQZ-së vërtetohet se të njëjtit nuk kanë aplikuar në periudhën e Aplikimit për Regjistrim për Votim Jashtë Kosovës. Po ashtu nga Formularët e Rezultateve të Kandidatit pas verifikimit të njëjtat rezultojnë të jenë në përputhje me të dhënat zyrtare të ofruar nga KQZ. Andaj edhe paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.985/2021 më datën 07.11.2021**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.